

# Angazhohu Monitoro Vepra



SUPLEMENT I GAZETËS NOSITI NGA GRUPI MONITORUES I TË RINJVE  
POGRADEC, GUSHT 2015 ÇMIMI 20 LEKË

## T'i imponohemi Pushtetit Vendor me intonacionin rinor!

MONITORIMI I  
KËSHILLIT  
BASHKIAK,  
POGRADEC  
DOSJA NR. 14




NJË RRUGËTIM I PAHARRUESHËM .....	faqe 2
THYERJA E HESHTJES .....	faqe 3
NE, MUND TË SJELLIM NDRYSHIMIN! .....	faqe 4
GJËRAT QË VËRTET LENË GJURMË NË JETË .....	faqe 5
ÇDO TË BËHET ME LAOKOONTËT? .....	faqe 6
NË KËRKIM TË VETËVETES .....	faqe 7
NJERIU PRA ËSHTË VETËVETJA .....	faqe 7
IDHULLI IM .....	faqe 7
NGJYROSE GJENDJEN SHPIRTËRORE .....	faqe 8

**ZGJIDHNI FJALËKRYQIN NË FAQEN 8 DHE MERRNI NJË  
DHURATË NGA GRUPI MONITORUES**

Ne ishim vullnetarët e parë pranë shoqatës “Unë, Gruaja”. U rritëm së bashku dhe u bëmë lidera.

Sot ne jemi trajnerët e projektit: “Më shumë të rinj në Leadership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare”.

Shumë të rinj pogradecarë i janë bashkuar nismës sonë, për të qenë të suksesshëm në jetë, për të marrë përgjegjësi dhe sfida qytetare. Ata nesër do të jenë liderat e së ardhmes.



**Bëhu**  
edhe  
**TI**  
**Lider!**

Apliko tani pranë shoqatës “Unë, Gruaja”, Pogradec. Telefono 083 222140

## Një rrugëtim i paharrueshëm

Gjithçka nisi si një trajnim i thjeshtë, ku shumë individë filluan të interesoheshin për të duke ditur një sërë suksesesh të arritura në mbështetje të shoqatës “Unë, Gruaja”. Nxënës, të punësuar, të papunësuar, studentë të moshave ndërmjet 16 dhe 25 vjeç u bënë pjesë e këtyre trajnimeve të ndërmarra nga persona të fushave dhe trajnimeve të ndryshme; duke kontribuar në formimin e liderave të së ardhmes, liderave të ndershëm dhe të denjë.

Unë isha pjesë e këtyre trajnimeve. Isha ndër fatlumët që patën, jo vetëm mundësinë, por edhe kënaqësinë të trajnoheshin nga mjekja Katerina Bardhi. Shoqata ofroi pesë kandidatë të denjë të cilët duhet të krijonin grupin e tyre prej 10-15 personash të moshave nga më të ndryshmet. Grupi në të cilin bëja pjesë unë ishte grupi me të interesuarit më të rinj në moshë (15-19 vjeçarë), kështu që mund të them se interesimi ynë nuk ishte vetëm maksimal krahasuar me të tjerët, por edhe trajneria na la mundësi të vinim në punë çdo aftësi tonën për t’i bërë këto leksione argëtuese dhe në të njëjtën kohë fitimprurëse.

Organizimi i trajnimit bëhej në këtë mënyrë: të gjithë takoheshim në një orar të caktuar pranë ambienteve të shoqatës dhe trajneria fillonte leksionin me pyetje të thjeshta në lidhje me temën që do të zhvillohej më pas, në mënyrë që të krijonte idenë midis asaj që ne dinim, mënyrën se si e konceptonim çështjen, me atë që ne do të mësonim atë ditë.

Pas disa minutash diskutimi, trajneria fillonte shpjegimet e saj, por gjithmonë duke na lënë ne që të shprehnim mendimet tona në lidhje me çdo temë. Temat e ezauaruara lidheshin me leadershipin duke qënë se dhe qëllimi lidhej drejtpërdrejt me të. Patëm mundësinë të flisnim se si është të jesh lider, çfarë cilësish mbart një lider, lideri dhe media, komunikimi si dhe vullnetarizmi, një temë pak e preur nga të rinjtë sot. Çdo diskutim i bërë vlejti deri në fjalën më



të vogël të tij pasi mes tyre arritëm të nxirrnim përfundime mjaft të vlefshme të cilat do të na shërbejnë më së miri në rrgët tona të jetës.

Ndryshe nga grupet e tjera që përfshinin grupmosha më të rritura, përfundimi i çdo leksioni ishte më i veçantë dhe më argëtues tek ne. Imagjinata dhe fantazia jonë vihej në zbatim. Aftësitë aktruese të Megi Vakos, oratoria e Inës dhe Rominës, shpirti karizmatik i Sarës, qetësia dhe matura e Xhenit dhe Aidës, thjeshtësia dhe shkathtësia e Joanës viheshin re çdo ditë.

Gjithçka që ne mësonim bëhej konkrete nga minidramatizimet që krijonim. Vinim “në skenë” situata konkrete të jetës të përditshme duke u përpjekur të shihnim më nga afër dhe të kuptonim më së miri atë që ne bënim dhe mësonim.

Me plot gojë secili nga ne kaloi momente shumë të këndshme në radhë të parë nga mikpritja e drejtueseve të shoqatës; zonjave Afroviti dhe Eleni, për të cilat shkojnë nderimet më të përzemërta, sikurse për trajneren tonë të dashur, të përkushtuar dhe të denjë e cila e bëri më të lehtë këtë trajnim saqë askush nuk arrinte të kuptonte se si orët kalonin pa kuptuar. Trajnimet mbarojnë me kurorëzimin e 12 liderave të rinj të grupit tonë të cilët me

mirëkuptim dhe bashkëpunim krijuan gazetën e tyre ku do t’u jepet mundësia secilit nga ne të dhurojë një pjesë të vetën përmes shkrimeve, fotove dhe çdo detaji që do të gjenden në faqet e kësaj gazete. Ky trajnim arriti të na bëjë të njohim veten, dëshirat dhe aftësitë tona. Sepse...si mund të drejtosh një grup kur nuk di të drejtosh veten? Dhe besojmë se kjo e fundit ishte arritja dhe qëllimi më kryesor i çdo mbledhjeje dhe takimi që u organizua. Urojmë përzemërsisht dhe besojmë se në të ardhmen do të kemi mundësinë të marrim pjesë në të tjera organizime apo trajnime të këtij tipi dhe të na jepet mundësia të miqësohemi me njerëz të rinj dhe të ndihmojmë veten dhe të tjerët të bëhen qytetarë të ndershëm të shoqërisë sonë.

**Xhenisa Boçka & Joana Angjo**



## Thyerja e heshtjes

### Retiçencë

Dhuna ndaj grave, ndonëse është shkelja më e përhapur e të drejtave të njeriut në botë, vazhdon të jetë më pak e vlerësuara. Dhuna është gjithashtu një problem i thellë shëndetësor që ka pasoja vdekjen dhe plagosjen, cënon mirëqenien e grave dhe shkatërron dinjitetin dhe vetëvlerësimin e tyre. Tashmë dihet se dhuna në familje i kapërcen të gjitha kufijtë dhe është prezente në të gjitha kulturat. Abuzimi ndaj grave është një problem kompleks dhe shumë dimensional. Shpjegimi për këtë duhet parë tek faktorët kulturorë, shoqërorë, familjarë dhe individualë, që ndikojnë në mundësitë që gratë të bëhen viktimat e dhunës.

Si rezultat i traditave të forta patriarkale të Ballkanit, shoqëria shqiptare ka qenë historikisht e dominuar nga meshkujt. Grave u është diktuar prej kohësh që të pranojnë rolin e të nënshtruarave.

Gjatë regjimit komunist u krijua një hendek i thellë midis teorisë për emancipimin e gruas dhe realitetit të saj të përditshëm.

Më 1991, pas përmbysjes së regjimit komunist, Shqipëria kaloi një periudhë ndryshimesh të mëdha, shpesh herë dramatike sociale, politike dhe ekonomike që ka krijuar një ndikim të thellë në jetën e shqiptarëve.

Barazia gjinore është për

shoqërinë shqiptare një princip i ri, që nuk është përqaftuar ende nga një përqindje e konsiderueshme e popullsisë.

### Ëndrra për martesën

Shumica e grave e kuptojnë martesën si një qëllim në jetë, megjithëse disa përmendin se motivi i tyre për t'u martuar ka qenë dëshira për t'u larguar nga shtëpia e prindërve, varfëria apo dhuna. Nga gratë, martesë përshkruhet si një normë dhe gjendje e dëshiruar për statusin social të grave. Gratë presin që martesë t'u krijojë mundësinë për një jetë të mirë dhe të lumtur, por shumë shpesh ajo u shndërrohet në një tablo poshtërimi, tensioni, kërcënimi dhe konflikti, dhe jo mundësi për plotësimin e ëndrrave.

### Përballja me realitetin

Për shumë gra, realiteti është krejt i ndryshëm nga ëndrra e tyre për një martesë ideale.

Rezultatet në një studim tregojnë se burrat e dhunshëm janë pro roleve dhe përgjegjësisë tradicionale familjare. Bashkëshortët e dhunshëm rezultojnë se janë imponues në marrjen e vendimeve familjare, ndërkohë që për gratë duan që t'i mbajnë shtëpinë, të kujdesen për fëmijët dhe t'u binden atyre.

Një burrë mund të reagojë në mënyrë të dhunshme nëse bindet

që gruaja e tij nuk e kryen si duhet rolin e saj, apo i kalon kufijtë e të drejtave duke ndërhyrë në kompetencat e saj. Gratë supozohet se duhet të kënaqen me rolin e tyre si bashkëshorte dhe nëna dhe të pranojnë se duhet të sakrifikojnë edhe jetën e tyre për hatër të martesës.

### Dhuna e ushtruar

Nga rrëfimet e grave rezultojnë se abuzimi është një fenomen kompleks dhe i formave të ndryshme që variojnë nga poshtërimi, kërcënimi, izolimi social, seksi me dhunë dhe rrahja. Dhuna ndaj grave bëhet e vazhdueshme dhe shpesh thellohet nga më e lehta në akte dhune tepër serioze. Dhuna fizike fillon nga një shpullë e deri tek goditja me armë. Shumë gra jetojnë me frikë, jo vetëm për jetën e tyre, por edhe për jetën e fëmijëve dhe familjes së tyre. Përvoja e grave të dhunuara seksualisht vërteton se dhuna bëhet e vazhdueshme dhe varion nga forma jo fizike të saj si tallja, kërcënime, fjalë poshtëruese dhe presion për t'i detyruar të kryejnë seks pa dëshirën e tyre, e deri në rrahje e përdhunim.

Dhuna fizike shpesh shoqërohet me tentativë për të kontrolluar ndërveprimet shoqërore të grave dhe lëvizjet e tyre. Disa burra i ndalojnë gratë që të shkojnë në punë. Pjesëmarrëset në studim përmendin si formë të abuzimit dhe abuzimin ekonomik. Kontributi financiar i grave në familje nuk ndikon apo zvogëlon pozitat dominuese të burrave të tyre në familje.

### Të qenit grua e abuzuar

Dhuna fizike e vazhdueshme, e shoqëruar me abuzime emocionale, seksuale dhe ekonomike, shkakton efekte të shumëfishta tek gratë. Për disa gra, abuzimet bëhen aq të padurueshme sa fillojnë të mendojnë edhe vetëvrasjen. Pasojë e dhunës së burrave nuk janë vetëm



mavijosjet, plagët dhe frakturat. Abuzimi është shkak i shumë gjymtimeve fizike, dështimeve dhe lindjeve të parakohëshme. Prandaj nuk është aspak çudi që gratë që janë abuzuar fizikisht, psikologjikisht apo seksualisht, kanë shqetësime emocionale. Shenjat më të zakonshme që përmendin gratë janë ankthi, depresioni, lodhja, nervozizmi, dhimbjet e kokës dhe probleme të mospërqëndrimit dhe pagjumësisë. Ato përmendin edhe ftohjen emocionale. Abuzimi i partnerëve shkatërron vetëvlerësimin e gruas dhe ndjenjën e kompetencës si person, grua, bashkëshorte, nënë dhe punonjëse. Disa gra i konsiderojnë pasojat psikologjike të abuzimit më serioze se efektet fizike të tij. Me kërkesën e partnerëve, gratë gjithashtu rrallojnë aktivitetet sociale. Këtë e bëjnë nga turpi ose për të mbrojtur fëmijët dhe miqtë.

### Thyerja e heshtjes

Dilemat personale të grave dhe vështirësitë e tyre për t'u shprehur për dhunën vihen re qartë në rrëfimet e tyre. Ndërgjegjësimi i tyre për të kuptuar se heshtja është e gabuar dhe se mbi të gjitha ato kanë mundësi të ndërmarrin hapa për ta përmirësuar situatën në të cilën ndodhen, janë strategjitë kyçe për zhdukjen e dhunës. Rrëfimet e grave vënë në dukje kulturën e tolerancës ndaj dhunës në familje, gjë që reflektohet në besimin se dhuna midis njerëzve më të afërt të familjes është një çështje private.

Emila Vojkollari



**Ne, mund të sjellim ndryshimin!**

**INICIATIVA**



Puna e palodhur e të rinjve të shoqatës ‘Unë Gruaja’, bashkëpunimi, komunikimi, rezultatet dhe përmirësimet u shpalosën denjësisht në konferencën e drejtuar nga përfaqësues të Kuvendit të të Rinjve të Kosovës (KRK) me organizimin e detajuar në mënyrë perfekte nga një anëtare e shoqatës, Ina Beçoku.

Kjo konferencë u mbajt në Pogradec, më 30 korrik 2015.

Të rinjtë pjesëmarrës u treguan të gatshëm për diskutim dhe debat, të tejmbushur me ide dhe informacione, arritën të transmetonin opinionet e tyre në lidhje me rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre në shoqëri, duke qenë kjo e fundit, tema e debatit. Mendje dhe ide të ndryshme sollën dhe debatet, ku përplaseshin mendime, të cilat ishin ndërtuar mbi baza të forta.

U diskutua shumë në këtë takim, ku u analizuan alternativat e mundshme të fuqizimit të rolit të të rinjve në shoqëri, duke erdhur kështu dhe konkluzionet e përfshirjes sa më të madhe të rinisë nëpër iniciativa, parti, grupime apo organizata joqeveritare.

Shoqata “Unë, Gruaja” tregoi denjësisht punën që kishte bërë me këta të rinj falë trajnerëve dhe stafit të shoqatës. Diskutimet dhe debatet vijuan me mendimet që të rinjtë duhet

të nxitën për pjesëmarrje në vendimmarrje apo në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme civile. Kjo, kërkon përveç vullnetit të tyre, edhe ndihmë nga institucione të ndryshme joqeveritare, të cilat janë të pakta funksionale në qytetin e Pogradecit.

U fol gjithashtu për nxitjen e punësimit të të rinjve nëpërmjet politikave efektive që kërkon tregu i punës, duke theksuar që të rinjtë duhet të angazhohen në partitë politike apo organizata të tjera, por nuk duhet të lejojnë që subjektet politike apo organizatat t’i ndryshojnë bindjet tona, por ne duhet t’i ndryshojmë qasjet politike të partive apo organizatave në të cilat angazhohemi.

Një pjesëmarrës hodhi idenë për edukimin e të rinjve, i cili ka të bëjë me arsimin profesional, pasi Shqipëria ka nevojë për vajza dhe djem të kualifikuar për të qenë të gatshëm në tregun e punës. U theksua gjithashtu edhe mbrojtja sociale, e cila lidhet drejtpërsëdrejti me ata të rinj të cilët kanë nevojë për dorën e shtetit duke bërë të mundur edhe aktivizimin e tyre.

Kultura dhe vullnetarizimi ishin dy faktorët, të cilët u mbështetën nga të gjithë. Faktorë të cilët do të bënin shoqërinë më të edukuar dhe më të lexuar, duke qenë qëllimi i vetëm: Të ecim përpara.

Ina Beçoku, organizatore e kësaj ngjarjeje, tha "të rinjtë duhet të angazhohen në partitë politike apo organizata të tjera, por nuk duhet të lejojnë që subjektet politike apo organizatat t’i ndryshojnë bindjet tona, por ne duhet t’i ndryshojmë qasjet politike të partive apo organizatave në të cilat angazhohemi".

Në këtë kontekst bëri thirrje edhe Sekretari i KRK-së, Enis Reçica, i cili theksoi se "përderisa, në ditët e sotme, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, zërat e vetëm që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në politikëbërje janë subjektet politike. Për këtë,



të rinjtë duhet të bëjnë përpjekje në angazhim në politikë edhe nëse është e nevojshme të kyqen drejtpërdrejt nëpër partitë politike, por duke mos ndërruar bindjet e tyre asnjëherë".

Ndërkaq, Armend Ahmeti deputet në KRK tha se "Sikurse një lule e cila ujitet vazhdimisht rritet me shpejtësi, e njëjta është edhe nëse për një ide angazhohemi shumë ajo do realizohet". Të njëjtin mendim e ndau edhe deputetja Ardita Sopi, e cila tha se "me këmbëngulje dhe përpjekje arrihet çdo gjë".

Në fund të gjithë debatit, të gjithë pohuan përfundimin e vetëm që të rinjtë janë mjaftueshëm të fuqishëm për të sjellë ndryshimin, për të dhënë dhe mbrojtur idetë, për t’i realizuar ato. Puna, vullneti, komunikimi, bashkëpunimi, fryma e tolerancës...

Janë të gjitha këto që bashkojnë të rinjtë në një qëllim të vetëm. Ne, mund të sjellim ndryshimin!

*Përgatiti: Emila Vojkollari.*



## Gjërat që vërtet lenë gjurmë në jetë

## INICIATIVA

Të mësosh të duash mund të ngjasojë me një ndër misionet më të vështira në jetë, por jo kur takon të tillë persona, të cilët të lehtësojnë çdo mision vetëm me një takim. Janë pikërisht këta persona, impakti i të cilëve është autentik, i ngrohtë, sikurëse vijjnë gjërat më të bukura dhe më të veçanta në këtë jetë.

Diskutuam shumë në grup për të ndërmarrë një iniciativë në komunitet, pas përfundimit me sukses të trajnimeve mbi leadershipin. Dhe vendosëm:

Në datën 12.05.2015, grupi jonë i leadershipit me trajnere Katerina Bardhin, vendosi të bënte një vizitë në ambientet e Qendrës së Personave me Aftësi të Kufizuara, Pogradec. Ishte një ndër pritjet më të ngrohta që kemi marrë ndonjëherë dhe për këtë gjë falenderojmë drejtoreshën e kësaj qendre, zonjën Anila Becri. Më tepër sesa dhamë dashuri, ndihma dhe mbështetje për atë qendër, të gjithë ne dolëm prej aty me ndjesinë e të qenurit të plotësuar. Nuk bëhet fjalë për ndonjë plotësim material që shumë persona kërkojnë të kenë sot, por plotësimi shpirtëror që këta fëmijë dhe të rritur na dhuruan atë ditë nuk mund të krahasohet me asnjë kënaqësi tjetër.

Duke folur dhe pyetur të gjithë ata për ëndrrat e tyre, pata ndjesinë e të lundruarit në rathët viciozë të luftës së përhershme që këta persona do të jenë duke përjetuar gjatë gjithë jetës së tyre. Aftësia dhe dëshira. Motivi dhe sjellja.

Ekziston një marrëdhënie simbiotike mes tyre sepse aftësia është ajo çfarë ti je i aftë të bësh, ndërsa motivi vendos se çfarë do të bësh dhe në fund sjellja vulos se sa mirë do e bësh diçka. Kuptova që ata ishin të aftë të bënin shumë që në momentin e parë që bënë shumë për ne, sepse të bëhesh ylber në renë e dikujt

është indikator shumë i mirë, që tregon se këta njerëz janë të aftë të bëjnë gjëra të mëdha.

Përfshirja e tyre në kompeticione dhe olimpiada të ndryshme, apo punimet që këta nxënës kishin arritur të bënin nën mbikqyrjen e kujdestares të tyre, të cilën e shihnin si një idhull të mirësisë dhe punës së palodhur, tregonin arritjet e tyre. Gjatë bisedës me drejtoreshën e qendrës ajo konstatoi se punë dhe vëmendje më të madhe duket t' u kushtohet fëmijëve autikë duke qenë se numri i tyre është rritur ndjeshëm.

Sipas saj, këta fëmijë e gjejnë tepër të vështirë integrimin në shoqëri, herë-herë duke shfaqur edhe shenja agresiviteti, sepse autizmi është pikërisht një çrregullim neurobiologjik që veçohet me vështirësi në komunikim, ndërveprimi shoqëror me sjellje të përsëritura dhe rreze të kufizuara interesash.

Nuk duhet të kemi frikë nga autizmi sepse është ashtu sikurse e cilëson profesor Edmond Tupe në librin e tij "Kur dhimbja premtion dashuri".

Mbase është e vështirë që personat me aftësi të kufizuara të pranohen normalisht në shoqërinë tonë. Kjo ndodh për shkak të keqinformimit apo do të ishte më mirë të quhej mosinformim ose injorancë e theksuar e



njerëzve. Fakti që atyre u shtohet një "kufizim" në cilësimin e tyre, nuk do të thotë që edhe universi që ata shpalosin para nesh është i tillë.

Madje universi i këtyre personave "normalë" që takojmë përditë është shumë herë më i kufizuar se këta persona të cilët quhen me aftësi të tilla. "Ata janë si ne dhe fatmirësisht shumë herë më me botë dhe me shpirt të bukur se pjesa më e madhe e jona".

**Ina Beçoku**



## Çdo të bëhet me laokoontët?

## Ese filozofike

Po e filloj me një histori, që në një mënyrë a një tjetër të gjithë duhet ta keni dëgjuar, edhe nëse jo, mund të përfitonit tani.

Pasi kishin kaluar shumë vjet, drejtuesit e grekëve, tashmë të kundërshtuar nga hyjnitë dhe të dërrmuar nga lufta, ndërtuan një kalë me përmasa të jashtëzakonshme, përmes artit hyjnor të një prej zdrukthtarëve më të zotë.

Grekët u hoqën sikur ky kalë madhështor do të ishte një trofe për trojanët, duke bërë të ditur kështu se ata po hiqnin dorë nga lufta. Të paktën kështu kam dëgjuar të flitej. Dhe ja ku qëndron Kali i Drunjtë përpara portave të Trojës. Priami shfaqet i lumtur nga froni i tij, buzëqesh duke menduar se më në fund Troja triumfoi, i pëlqen të mendojë se Grekët hoqën dorë pa i lodhur së tepërmi trimat trojanë dhe ndonëse as vetë nuk po i beson mendimet e tij, përsëri pranon që Kali të futet në trojet trojane.

Në këtë çast dëgjohet nga larg një zë i mbytur, i cili nxiton t' i afrohet turmës dhe të flasë për kurthin që ai mendon se po i kryhet Trojës. Dhe përpara turmës qëndron Laokoonti, i cili me padurim fillon të flasë: "O qytetarë që nuk keni njohur lumturi! Ç'është kjo çmenduri e tillë? A mendoni se armiku u zhduk dhe notoi larg? A thoni të ketë hequr dorë kaq shpejt? E pastaj përse kjo dhuratë? Pse ky kalë? Ose ka grekë të fshehur aty, të fshehur pas drurit, ose ai është ndërtuar si një makineri e madhe për t' u përdorur kundër mureve tona, ose për të spiunuar shtëpitë tona, ose kushedi ç' dredhi mund të fshehin tjetër. Trojanë, mos i besoni këtij kali!"

E si tha këto fjalë, lëshoi heshtën e vet mespërmas kalit dhe e mbylli fjalimin me shprehjen e famshme të Virgjilit "U druhem grekëve, edhe kur bëjnë dhurata."

Siç pritej, Poseidioni i tërbuar, që mbante anën e grekëve, nuk ngurroi t' i mbyllë me forcë gojën Laokoontit dhe i dërgoi në shtëpi dy gjarpërinj që të helmonin atë dhe të dy bijtë e tij, përpara se trojanët ta besonin paralajmërimin e Laokoontit.

Kështu i gjori Laokoont vdiq me brengë në zemër duke u përpjekur të shpëtojë fëmijët e tij, por e vërteta në shpirtin e tij nuk mundi të vdiste. Në Trojë hyn Kali i Drunjtë dhe më pas e dimë të gjithë si vazhdon historia. Sikur të kishin dëgjuar Laokoontin, por ç' e do? Kush ishte ai që të dëgjohej, gjithsesi? Një i shkretë që u përpoq të hidhte dritë mbi popullin e vet, një trojan që mundi të deshifronte mjeshtërisht tradhëtinë e Kalit të Trojës para se ajo të ndodhte, por përsëri grekët e mbyllën dhe trojanët nuk denjuan ta ndihmonin, dhe për pasojë ua dhuruan historinë grekëve dhe ata e nënshkruan dhe e vulosën me kthetrat e


tradhëtisë. Pra ç' ishte Laokoonti dhe njëherë? Një trojan që refuzoi të besonte se gjithçka do të merrte fund aq lehtë, një trim që megjithëse e dinte që me shumë mundësi do i mbyllej goja brutalisht, si dhe ndodhi në të vërtetë, nuk ngurroi të dilte para turmës dhe të thoshte të vërtetën.

A thua të ishte një turmë e shurdhët? E nëse s' do ishte, përsëri do shurdhohej me forcë nga Poseidoni e të tjerë që ushqenin të njëjtat interesa me të? Laokoonti refuzoi të pranojë kaq thjesht se armiku grek mori arratinë dhe shpalosi turpshëm flamurin e paqes. Pra si përfundim kush ishte Laokoonti? Një i pafat në dejet e të cilit nuk rridhte gjak pushtetari, vetëm kaq. Ç' i solli atij refuzimi i hapur për pranimin e dhuratës? Vdekje, mort, po jo nga gjarpërinjtë, jo këtë version nuk e besoj aspak.

Ai kish filluar të vdiste para se helmi i gjarpërinjve të mund të kridhej në venat e tij të pafajshme. Helmin më vdekjeprurës e mori kur pa shurdhimin e turmës nga dora e pushtetit, i cili e injoroi në mënyrë poshtëruese, sikur paralajmërimi i tij mos të kishte ekzistuar kurrë apo sikur mos të kishte ekzistuar edhe vetë qenia e tij e pafat.

E kur mendoj për Laokoontin, afëmendsh mendoj e për ata njerëz sot që nuk kanë forcë të përballen me "Poseidonët" që natyrisht veshin maska të ndryshme, por përbëhen nga të njëjtat materiale poshtë veshjeve që mbulojnë aq shumë, mendoj për këta njerëz që e njohin të vërtetën e madhe, por që shtypen si "morra" e vriten si "parazitë" në mënyra nga më të ultat dhe prapë s' ka se si mos të kthehem te Laokoonti. Te i mjeri Laokoont, që mitologjia greke e krijoi për të përfaqësuar këta njerëz të cilëve helmi po u gërryen shpirtin, këta njerëz që kanë shumë zë, por zor se dëgjohej.

E sikur mos t' i mjaftonte ajo vrasje e pamëshirshme, Laokoontit iu desh të përballlej



me faktin se fatkeqësisht kishte pasur të drejtë, iu desh të shihte Trojën t' i përmysej e bëhej hi përpara syve, e të vdiste aty, jo i vetëm, por bashkë me gjithë trojanët e tjerë, të cilët aq thjesht mund t' i kishte shpëtuar, por nuk varej nga dora e tij.

E kjo më çon në një pyetje: Ç' do të bëhet me ata që çirren se dinë si të ndalojnë tragjedinë, por që nuk i dëgjojmë sepse çjerrja e tyre nuk na ledhaton aspak veshin? Ç' do të ndodhë kur këta njerëz të prozvalen nga dy duar më të mëdha se të tyret, të cilat thyejnë kockat e laokoontëve si të ishin shkopinjtë të hollë?

Mua më ngushëllon vetëm diçka: Që Laokoonti edhe pse është një statujë mermeri nëpër muzeume botërore, ashtu siç paraqitet nga i madhi Kadare, përsëri vazhdon të qajë për të vërtetën e të vuajë për të.

Për ju ndoshta tingëllon absurde që një dhimbje kaq e rëndë të më ngushëllojë, por çdo gjë e ka një shpjegim dhe shpjegimi im është ky: ndoshta ndonjë ditë, jo shumë të largët (shpresoj!) dikush do të dijë të lexojë lotët e akullta që shkrijnë mermerin e asaj statuje dhe do të arrijë të kuptojë të vërtetën që qëndron e murosur dhe e gdhendur aty në zbrazëtirë.

Dhe më në fund ky njeri do kuptojë ato jehonat që oshëtinë me dhimbje nga çdo cep i muzeut, më në fund do dëgjojë thirrjen kumbuese e drithëruese që Laokoonti përsërit pa mbarim: "Mos lejoni që historia të përsëritet!" Gjithsesi nuk di ç' të bëj tjetër veçse të shpresoj se do të vijë dita që laokoontët të dëgjohej e të çmohen, se laokoontët janë kaq shumë dhe është mëkat që të dëgjohej kaq pak, se laokoontët dinë shumë dhe është mëkat të marrin pak, se laokoontë jemi të gjithë ne dhe është mëkat të na thyejnë. Në fund të fundit historia e ka treguar në shumë raste që laokoontët kanë lindur për t' u dëgjuar.

**Megi Vako**



## Në kërkim të vetëvetes

Teksa shfletojmë nëpër faqet e librave të raftit të bibliotekës t'nde personale ndeshesh me një shumëllojshmëri personazhesh të cilët ti fare mirë mund t'i dallosh nga njëri-tjetri. Ashtu sikurse një mësuese, sado nxënës të ketë kaluar nëpër vite, mund t'i risjellë ende ndërmend emrat e tyre duke i lidhur



ata me cilësi të veçanta që i karakterizojnë.

Kështu është i ndërtuar ky planet, kështu është krijuar ky ligj natyre, i cili fare mirë ka ditur që të mos ndeshen asnjëherë dy persona të njëjtë, por ka spërkatur si me magji cilësi, tipare dhe karakteristika të ndryshme për persona të ndryshëm. Secili prej nesh është unik, por e rëndësishme është që në fund të ditës të kuptojmë se kush jemi dhe të

vlerësojmë atë që jemi pasi është pikërisht ajo që na veçon dhe na dallon në këtë "xhungël" të ngatërruar njerëzore.

Njerëzit shpesh janë të prirur të

dëshirojnë atë që tjetri mbart. Lakmia për të qenë si dikush tjetër dhe rritja e nënvlerësimit për veten bën që të shumëfishohen fytyrat njerëzore duke bërë që të nxjerrin në pah dy lloj personalitetesh, atë real dhe një (dy, disa) të shtirur për të gënjyer të tjerët dhe veten në radhë të parë, duke u kënaqur me lugën bosh.

E rëndësishme është të shmangim të qenurit dikush tjetër, ku fare mirë mund të zbulojmë atë

që jemi vërtet dhe ta përsosim duke shfrytëzuar çdo karakteristikë tonën.

Edhe sikur të dalim kundër rrymës, arrin për një moment e ti përjeton të qenurit vetvetja pa kompleksitetin e mospranimit nga të tjerët. Duke u shtirur si dikush tjetër, ti je duke mosrespektuar veten. Por kur njeriu nuk arrin të respektojë atë që ai është, si mund të presë respektin e të tjerëve? Të shtireshtë është tërësisht e gabuar. E gabuar për faktin se askush dhe asgjë nuk duhet të të detyrojë ty të dalësh nga vetja. Bëhu unik duke treguar sesa vend të

rëndësishëm e të çmuar ke në këtë shoqëri të komplikuar, vlerat e së cilës zbehen vazhdimisht.

Kërko vetveten, duke mos patur frikë nga emocionet, pengesat apo dështimet. Zbuloj atë që je në të vërtetë dhe ke për të kuptuar se brenda teje merr jetë një botë e pasur me vlera, ëndrra e dëshira të cilat do të të ndihmojnë ty në rrugëtimin tënd të gjatë të jetës. Vetëm në këtë mënyrë, do të mund të përballosh gjithçka pa u fshehur pas petkut të mashtrimeve. Ji i vërtetë, ji vetvetja!

**Xhenisa Boçka**

## Idhulli im

Secili prej nesh, mbi ëndrrat e fëmijërisë, me dëshirat e adoleshentit dhe me vendosmërinë e një të rrituri, kërkon të arrijë çdo synim të tij. Kryesisht ndodh që kërkon të bëhesh si dikush, ose do të ndjekësh hapat e tij drejt suksesit apo të arritjeve të mëdha të tij. Në mendje na vjen ai momenti kur pyet dikë të vogël se çfarë do të bëhet kur të rritet dhe ai përgjigjet: "Si mami, si babi". Në ato momente arrin të kuptosh se në jetën e këtij fëmije ekziston dikush shumë i rëndësishëm, i cili e udhëheq atë drejt asaj rruge të mbarë për sukses. Pikërisht këta persona njihen me fjalën "idhull".

Idhujt tanë mund të jenë nga më të ndryshmit, realë ose imagjinarë, familjarë, miq apo edhe të njohur. Këta persona karakterizohen nga një sërë virtytesh apo arritjesh, të cilat i bëjnë ata të veçantë për të tjerët. Këto cilësi arrihen të vihen më në pah nga ata të ashtuquajturit ndjekës.


Idhujt vlerësohen si figura të përsosmërisë ideale për dikë. Ata janë në gjendje të ndikojnë aq thellë në psikikën e të tjerëve sa mund të krijojnë në mendjen e tyre imazhin e një personi të përkryer, i cili ia vlen të kopjohet. Shpesh emocionet përfshihen në këtë vorbull mendimesh dhe idesh duke e bërë më të ngushtë lidhjen idhull-individ.

Nuk besoj se ekzistojnë njerëz, të cilët të mos kenë pasur të paktën një herë në jetën e tyre një idhull, një person të adhuruar. Nëpërmjet tyre ata janë në gjendje të zbulojnë vetveten dhe të venë në praktikë aftësitë e tyre.

Të kesh një idhull nuk është domosdoshmërisht diçka e gabuar, pasi shpesh njerëzit besojnë se ata dalin nga vetja duke dëmtuar veten dhe sfiduar me pamundësinë për t'u bërë si dikushi.

E rëndësishme është të arrijmë majat e suksesit pavarësisht nëse ata janë apo jo një idhull e nëse ekziston një i tillë të përpiqemi të marrim pjesën më të mirë të tyre, të përsosim ato cilësi dhe të shndërrohemi në qytetarë të ndershëm të së ardhmes.

**Xhenisa Boçka**



## Njeriu pra është vetëvetja



Njeriu është e vetmja krijese e cila nuk pranon të jetë ai që është.

Njeriu është qenia që nuk mund të krahasohet me asnjë tjetër. Një krijesë kaq inteligjente, e zgjuar, me ndërgjegje të plotë që vepron me anë të arsyes, por që nuk mund t'i bëjë dot ballë jetës të tij. Përballë jetës shfaqet si i frikësuar ndaj të panjohurës, ka dobësi për forcën e tij dhe i trembur për fatkeqësitë dhe grackat që jeta i thur. Ai është i mbërthyer nga dyshimi, sepse duke qenë në thelb refleksi i asaj që presin prej tij në një farë mënyre, ai humb identitetin e vet. Ne njerëzit kemi një jetë të vështirë, sepse kështu janë ligjet e

natyrës, e megjithatë shpesh mundohemi të largojmë sadopak nga vetëvetja hallet e përditshme. Duke u përpjekur të përcaktojmë vetë thelbin e jetës, duke mos u varur prej kurrfarë force që qëndron jashtë tij, ai është i lirë, është dënuar të jetë i lirë. Duke qenë i lirë njeriu duhet të zgjidhë një mori mundësish duke ndërtuar personalitetin e dinjitetin e tij. Njeriu pra është vetëvetja. Por megjithatë kushtet ku ai jeton e bëjnë të mos e pranojë vetëveten. Ai është i vetmi përgjegjës për të gjitha proceset e tij, meqënëse vetëm atij i takon të zgjedhë se cili është në jetë. Meqë, kjo qenie që është njeriu, është e lirë, i duhet ta angazhojë lirinë e vet përndryshe mbetet rob i saj. Në përshtatje me angazhimin që zgjedh njeriu, e shfrytëzon lirinë e tij të qenësishëm në dobi të njerëzimit, çdo veprim i pamotivuar përbën një vetëmashtrim, për të cilin ai vetë është përgjegjës për të ardhmen e tij në këtë botë.

**Sara Angjo**

## Ngjyrose vetë gjendjen tënde shpirtërore



E kuqja është e lidhur me energjinë, padurimin dhe ambicien. Provo të ulesh në një dhomë të kuqe për pak, e do të shohësh se zemra fillon të të rrahë më shpejt dhe do të ndihesh paksa në siklet, i inatosur dhe si i bezdisur. E kuqja gjithashtu stimulon oreksin, prandaj disa restorante lyhen me të kuqe. Ajo tërheq vëmendjen dhe është ngjyra e dashurisë, prandaj vishni të kuqe nëse dëshironi që dikush t'ju verë re.

E keni të vështirë të shtroheni në punë?

Atëherë lyejeni dhomën e studimit me blu. Është ngjyra e mendjes, dhe ndihmon përqëndrimin. Bluja e lehtë është qetësuese dhe relaksuese, prandaj është perfektja për të çliruar stresin.

E gjelbra është ngjyra e natyrës dhe e shërimit dhe të bën të ndihesh i qetë dhe i rifreskuar. Njerëzit që shfaqen në ekran zakonisht para shfaqjes, ulen në dhoma të gjelbra. Edhe spitalet përdorin ngjyrën e gjelbër për të relaksuar pacientët. Për më tepër, të ndihmon të biesh në gjumë.

Lejlaja lidhet me mbretërimin dhe pasurinë, sepse bojët lejla kanë qenë shumë të shtrenjta për t'u prodhuar. Do të jesh më shumë krijues dhe me më shumë imagjinatë? Rrethoje veten me lejla. Çliron ankthin dhe sjell rehati. Është edhe romantike, gjithashtu.

E verdha e fortë sigurisht tërheq vëmendje.



Është ngjyrë plot hare që të ndihmon të krijosh vetëbesim dhe të ndihesh i sigurt, optimist dhe i lumtur. Nga ana tjetër e verdha e zymtë është pak ngjyra e frikës. Njerëzit e humbasin temperamentin në dhoma të verdha dhe bebet qajnë shumë.


Po shkoni në një festë? Portokallia të ndihmon të ndihesh energjik, i lumtur dhe i shoqërueshëm. Por... nëse e vesh shpesh, njerëzit mund të mos të të marrin shumë seriozisht.

E bardha është ngjyra e pastërtisë. Simbolizon pafajësinë dhe qejfin. Shpenzoni kohë në një dhomë të bardhë dhe të pastër nëse doni të organizoni mendimet dhe emocionet. Jini të kujdesshëm, gjithsesi! Shumë e bardhë të bën të ndihesh i vetmuar dhe të ndan nga njerëzit.

E zeza të bën të ndihesh misterioz dhe i fuqishëm. Mund të preferosh të zezën kur ke dëshirë "të fshihesh nga bota". Është një ngjyrë gjithmonë e modës, sepse është elegante dhe nuk i ikën kurrë koha. Mund të jetë pak e frikshme, megjithatë. Të gjithë personazhet negativë, veshin të zezën, si Drakula.

**Joana Angjo**

## Fjalëkryqi i lidërshtipit



1. Tipi i liderit jo bashkëpunues quhet lider \_\_\_\_\_.
2. Fushata pro homoseksualitetit quhet fushata \_\_\_\_\_.
3. Radiot, gazetatat, TV, etj. quhen \_\_\_\_\_.
4. Lideri që nuk kërkon llogari quhet lider \_\_\_\_\_.
5. Gjatë një interviste, është i rëndësishëm komunikimi me \_\_\_\_\_.
6. Një ndër fushatat e shoqatës "Unë, Gruaja" është ajo HeFor \_\_\_\_\_.
7. Modeli i liderit që duhet të ndjekim është ai \_\_\_\_\_.
8. Sinonim i fjalës lider në shqip \_\_\_\_\_.
9. Shpërndarja e informacionit përmes internetit quhet komunikim nëpërmjet \_\_\_\_\_.
10. Ngjyra portokalli na kujton luftën kundër dhunës ndaj \_\_\_\_\_.

Përgatiti: **Joana Angjo**

### Të rinjtë pjesëmarrës

Trajnere: **Katerina Bardhi**

1. Xhenisa Boçka
2. Joana Angjo
3. Megi Vako
4. Ina Beçoku
5. Sara Fezollari
6. Emila Vojkollari
7. Kristiana Çoçka
8. Kristina Nasto
9. Letiona Buzo
10. Stiven Veizi
11. Romina Zade
12. Aida Laraku

**Projekti:** Më shumë të rinj në lidërshtip nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare.

Ky projekt mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.